

REZOLUTË
PËR LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRUAS DHE RITJEN E DIMENSIONIT
PARLAMENTAR TË LUFTËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke njohur detyrimin e shtetit për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas të gjitha akteve ndërkombëtare dhe legjislationit të brendshëm;
- Duke e trajtuar dhunën në familje si shkelje e të drejtave të njeriut dhe si një çështje që i përket gjithë shoqërisë;
- Duke vlerësuar se dhuna ndaj gruas dhe dhuna në familje, në të gjitha format e tyre, shkaktojnë pasoja të rënda në shëndetin fizik dhe mirëqenien psikologjike të viktimave të dhunës (kryesisht grave dhe fëmijëve);
- Duke e konsideruar dhunën ndaj grave jo vetëm si një problem që lidhet me shëndetin publik, por si shprehje e pabarazisë gjinore në familje dhe shoqëri;
- Duke e vlerësuar dhunën si një çështje komplekse që ka nevojë për një ndërhyrje multidisiplinare dhe të vazhdueshme;
- Duke mbështetur fuqimisht veprimtarinë e autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe luftën kundër dhunës në familje;

Ripërsërit angazhimin dhe vendosmërinë:

- Për domosdoshmërinë e kontributit të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë për të përmirësuar dhe rritur efikasitetin e legjislationit për parandalimin dhe ndëshkimin e dhunës ndaj grave e dhunës në familje dhe për të mbikëqyrur zbatimin e këtij legjislationi që synon eliminimin e dhunës në familje;
- Për të rritur kontributin e Kuvendit në ndërgjegjësimin e opinionit publik, lidhur me konsiderimin e dhunës në familje si shkelje të të drejtave të njeriut.

Thekson nevojën:

- Për të intensifikuar përpjekjet dhe veprimtaritë e Kuvendit, në kuadër të fushatës së Këshillit të Europës “Parlamentet e bashkuara në luftën kundër dhunës në familje”;
- Për të nxitur shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme financiare, në zbatim të legjislationit në fuqi për luftën kundër dhunës në familje;
- Për të rritur angazhimin e të gjithë aktorëve të shoqërisë shqiptare në edukimin e vajzave dhe djemve për një shoqëri pa dhunë;
- Për krijimin dhe mirëfunksionimin e mekanizmave të referimit për viktimat e dhunës në familje;
- Për hartimin e politikave sociale që adresojnë faktorët që lindin apo mbajnë gjallë dhunën në familje;
- Për të monitoruar zbatimin e kuadrit ligjor dhe të politikave, lidhur me të drejtat e njeriut dhe luftën kundër dhunës në familje;
- Për të rritur koordinimin e veprimtarisë së të gjithë aktorëve të shoqërisë shqiptare për parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje;
- Për të nxitur dhe mbështetur krijimin dhe funksionimin e qendrave strehuese për viktimat e dhunës në familje.

Kuvendi angazhohet:

- Të përmirësojë legjislationin ekzistues, duke parashikuar sanksione më të forta për dhunuesit dhe konsiderimin e dhunës në familje si vepër penale;
- Të organizojë një Konferencë Kombëtare Parlamentare të përvitshme që të vlerësojë zbatimin e masave kundër dhunës në familje dhe të inkurajojë bashkëpunimin mes autoriteteve shtetërore në nivel qendror e vendor dhe shoqërisë civile, me qëllimin e përbashkët minimizimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje.

2 dhjetor 2010

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)